

**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

**KGJK.nr.415/2021**  
**Datë: 29 dhjetor 2021**


**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**, në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1.24 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe nenit 30 të Rregullores Nr. 03/2021 mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në takimin 274-të, të mbajtur me 29 dhjetor 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet Struktura Organizative (“Organogramin”) e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, sipas këtij organizimi funksional:
  - 1.1. Kryesuesi i Këshillit;
    - 1.1.1. Kabinet i Kryesuesit të Këshillit;
    - 1.1.2. Njësia e Auditimit të Brendshëm;
      - 1.1.2.1 Njësia e Auditimit të Brendshëm udhëhiqet nga Drejtori i Njesisë i cili i përgjigjet dhe i raporton drejtpërdrejtë Kryesuesit të Këshillit, ndërsa të punësuarit në Njësi i përgjigjen dhe i raportojnë Drejtorit.
    - 1.1.3. Zyra për Komunikim me Media dhe Publikun;
      - 1.1.3.1 Zyra për Komunikim me Media dhe Publikun udhëhiqet nga Udhëheqësi i Zyrës i cili i përgjigjet dhe i raporton drejtpërdrejtë Kryesuesit të Këshillit, ndërsa të punësuarit në Zyrë i përgjigjen dhe i raportojnë Udhëheqësit.
  2. Komisionet e përhershme të Këshillit:
    - 2.1 Komisioni për Çështje Normative;
    - 2.2. Komisioni për Vlerësimin e Përformances së Gjyqtarëve.
    - 2.3. Komisioni për Administrimin e Gjykatave;
    - 2.4. Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel;
    - 2.5. Komisioni për Trajnime.
  3. Komisionet dhe Panelet:
    - 3.1. Komisioneri për Përgjime;
    - 3.2. Paneli për Lirim me Kusht; dhe
    - 3.3. Komisioni për Kompensimin e Dëmit për Personat e Dënuar ose Arrestuar pa arsye.
  4. Njësitë e Këshillit:
    - 4.1. Sekretariati i Këshillit; dhe
    - 4.2. Njësia për Inspektim Gjyqësor.

2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është skema organizative, përkatësisht organogrami i Këshillit.

3. Obligohet Komisioni për Çështje Normative që jo me vonë së 3 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të sjell për miratim në Këshill Rregulloren për funksionin e njësive të Këshillit sipas kësaj strukture.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Gjyqësor.



Albert ZOGAJ,  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

*Kopje e vendimit t'i dërgohet:*

- Drejtorit të Përgjithshëm të SKGJK-së;
- Arkivit të KGJK-së.